

DORACAK
PËR
TATIMIN MBI VLERËN E
SHTUAR
NË KOSOVË

Përmbajtja e lëndës

1. Hyrje
2. Ç'është tatimi mbi vlerën e shtuar ?
3. Si funksiononon TVSH-ja ?
4. Regjistrimi i TVSH-së .
5. Ç' duhet të bëni për t'u regjistruar?
6. Detyrimet pasi të regjistroheni .
7. Biznesi me më tepër se një vend pune.
8. Çregjistrimi.
9. Kontrollat e TVSH-së .
10. Deklarata e TVSH-së .
11. Rimbursimi i TVSH-së .
12. Bazat e kontabilitetit.
13. Fatura tatimore.
14. Nota e kreditit.
15. Nota e debitit
16. Agjentët.
17. Veprimtaria ekonomike.
18. Furnizimet e tatueshme me zero përqind.
19. Shitja e veprimtarisë ekonomike.
20. Misionet e ndërlidhjes, UNMIK-u, KFOR-i, Banka Botërore, organizatat ndërkombetare dhe ndërqeveritare.
21. Individët.
22. Importi dhe hyrjet nga RFJ –ja .
23. Furnizimet e përjashtuara.
24. Furnizimet e perziera.
25. Sigurimet.
26. Ndërtimi.
27. Mbajtja e regjistrimeve.
28. Deklarimi .
29. Si të plotësohet deklarata juaj e TVSH-së?
30. Borxhi i keq .
31. Mjetet kryesore .
32. Rikthimi.
33. Tatimet e tjera
34. Shembulli.
35. Përfundimi

1) Hyrje

Qëllimi i këtij doracaku është të ndihmojë personat e tatueshëm të TVSH-së në plotësimin e obligimeve të tyre duke i siguruar ata me një sqarim të thjeshtë për obligimet e tyre tatimore. Kjo broshurë nuk është dokument ligjor dhe destinohet të përdoret vetëm si doracak.

Për këshilla duhet të kontaktohet Administrata Tatimore. Kërkesat specifike duhet të bëhen me shkrim dhe të përcillen në:

Administrata e Tatimore e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave
Sheshi „Skënderbeu „ ish- ndërtesa e e Gërmisë.

Prishtinë

Tel:0381-38-211 / 069

e-mail: { [HYPERLINK "mailto:taxinfo21@yahoo.com"](mailto:taxinfo21@yahoo.com) }

2) Ç'është tatimi mbi vlerën e shtuar?

Tatimi mbi vlerën e shtuar apo TVSH-ja është një tatim mbi konsumin. Zbatohet në mallrat dhe shërbimet të kryera nga personi i tatueshëm në Kosovë dhe në importet dhe hyrjet nga RFJ-ja. Shkalla tatimore (përqindja) normale e TVSH-së është caktuar 15% e vlerës së mallrave dhe shërbimeve të furnizuara dhe të sjellura në Kosovë. Po ashtu ekziston TVSH-ja me 0% në eksportet, Daljet drejt RFJ-së dhe transportin ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtarëve.

3) Si funksionon TVSH-ja ?

Ju do të paguani 15% TVSH-në në të gjitha blerjet tuaja të mallrave dhe shërbimeve nga furnizuesit e regjistruar. Ju po ashtu do të paguani 15% TVSH-në në të gjitha importet tuaja dhe hyrjet nga RFJ-ja .Si person i regjistruar i TVSH-së , i cili kërkohet të deklarojë, ju duhet të arkëtoni 15% TVSH nga konsumatorët tuaj në furnizimin e shumicës së mallrave dhe shërbimeve. Keto quhen furnizime të tatueshme. Eksportet dhe daljet nëpërmjet RFJ-së janë, po ashtu furnizime të tatueshme , por tatimi mbi vlerën e shtuar në eksportet dhe daljet drejt RFJ-së është 0% dhe si pasojë shuma e tatimit në eksportet dhe daljet drejt RFJ-së do të jenë zero.

Në fund të çdo muaji ju do të plotësoni deklaratën e tatimit mbi vlerën e shtuar. Deklarata i ka dy blloqe kryesore, njëra quhet tatimi i llogaritur dhe tjetra quhet **tatimi i zbritshëm**. Tatimi i llogaritur është tatimi të cilin ju e zbatoni dhe e arkëtoni nga konsumatorët tuaj. Tatimi i zbritshëm është tatimi të cilin furnizuesit tuaj e arkëtojnë nga ju dhe tatimi të

Ministria e Ekonomisë dhe Financave
Administrata Tatimore

cilin ju e keni paguar në importet tuaja dhe hyrjet nga RFJ-ja . Ju do të deklaroni tatimin tuaj të llogaritur, pastaj do të zbritni nga ajo shumë tatimin e zbritshëm të lejueshëm. Diferenca do të jetë një shumë (debit) që do të duhet të paguhej apo një tatim i paguar tepër (kredit) që do të mbartet apo rimburohet nëse të gjitha kushtet janë plotësuar. Pastaj do të dorëzoni deklaratën dhe pagesen në Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (BPK) apo Pro Kredit Bank (Micro Enterprise Bank- MEB) apo në ndonjë bankë tjetër në Kosovë që mund të autorizohet në të ardhmën.

Ju nuk do të lejoheni të zbrisni TVSH-në e paguar në mallrat dhe shërbimet e marra për përdorim personal. Ju do të lejoheni të zbrisni tatimin e zbritshëm në mallra dhe shërbime të shfrytëzuara për qëllime biznesi. Furnizimet për biznese përfshijnë mallrat , sikurse janë makineria, mobiljet, ndërtesat apo shërbimet sikurse janë sigurimi, ndërtimi, pastrimi, kontabiliteti, ruajtja (mbrojtja).

Nëse shuma e kombinuar e importeve, hyrjeve nga RFJ dhe blerjeve në Kosovë të mallrave dhe shërbimeve është më e lartë se shuma e shitjeve, ju mund të jeni në pozitë të tatimit të paguar tepër (pozitë kreditore) dhe të lejoheni për rimbursim sepse, në atë rast, tatimi i paguar do të jetë më i lartë se tatimi i arkëtuar. Ju poshtu mund të lejoheni për rimbursim nëse keni eksporte apo dalje drejt RFJ-së , ku shkalla e TVSH-së në këto raste është zero por ju lejoheni të kreditoni tatimin e paguar në blerjet, importet dhe hyrjet nga RFJ-ja .

4) Regjistrimi për TVSH

Biznesi, qarkullimi vjetor i të cilit është më i lartë se 200,000 DEM në vitin kalendarik duhet të regjistrohet për TVSH. Pashtu të gjithë personat të cilët importojnë , eksportojnë , kryejnë hyrje nga RFJ-ja dhe dalje drejt RFJ-së kërkohet të regjistrohen pavarësisht nga shuma e qarkullimit dhe nga qëllimi i importimit apo hyrjes.

5) Ç'duhet të bëni për t'u regjistruar?

Ju duhet të kontaktoni Zyren tuaj tatimore regjionale apo lokale në Kosovë për të marrë aplikacionin e regjistrimit. Formularët e aplikacioneve janë në dispozicion në të gjitha zyret e shërbimit të tatimpaguesve në Kosovë. Pasi të jetë shqyrtuar kërkesa juaj, Administrata Tatimore do t'ju japë numrin e regjistrimit që do të paraqitet në çertifikatën e regjistrimit. Numri regjistruar i TVSH-së do të jetë i njëjtë sikurse numri i përkohshëm regjistruar i biznesit.

6) Detyrimet pasi të regjistroheni

Nëse jeni regjistruar për TVSH, keni marrë çertifikatën e regjistrimit që përmban numrin tuaj identifikues dhe keni mbi 200,000 DM qarkullim, nga ju kërkohet të aplikoni dhe mbledhni TVSH-në në furnizimet e mallrave dhe shërbimeve për konsumatorët tuaj. Nga ju poshtu kërkohet të lëshoni faturën tatimore për secilën shitje. Të gjitha faturat tatimore duhet të regjistrohen në librin e shitjes. Për të pasur mundësi të merrni avantazh për kreditim të tatimit të zbritshëm, ju poshtu duhet të merrni faturën tatimore apo dokumentin e importit që duhet të regjistrohet në librin e blerjes. Duhet të kompletoni

deklaratën çdo muaj dhe ta dorëzoni atë së bashku me pagesën e tatimit në BPK apo MEB. Deklarata juaj duhet të pranohet deri në ditën e fundit punuese të muajit vijues të periudhës tatimore.

7) Biznesi me më tepër se një vend pune

Kompania/firma e cila ka më tepër se një degë apo vend të punës së biznesit do të kërkohet të regjistrojë secilën prej tyre dhe të marrë Çertifikatën e TVSH-së për secilën prej tyre, por vetëm një numër i TVSH-së unik do të paraqitet në të gjitha. Kur të kompletoni aplikacionin e regjistrimit ju duhet ta siguronit Administratën Tatimore me listën e detajuar të të gjitha vendeve të biznesit dhe adresat e tyre specifike dhe numrat e telefonit. Personi i tatueshëm duhet të deklarojë vetëm një deklaratë tatimore, duke i konsoliduar shitjet dhe blerjet e të gjitha degëve apo vendeve të biznesit, pa marrë parasysh se sa janë.

8) Çregjistrimi

Nëse nga ju nuk kërkohet të jeni i regjistruar, mund të kërkoni të anuloni regjistrimin e TVSH-së duke dorëzuar një aplikacion në Administratën Tatimore. Nga ju do të kërkohet të kompletoni formularin e ndryshimit të regjistrimit të TVSH-së dhe të tregoni arsyen e anulimit të regjistrimit. Regjistrimi i juaj i TVSH-së do të anulohet vetëm pasi Administrata Tatimore të jetë e bindur se ju nuk keni nevojë më të jeni i regjistruar. Nëse regjistrimi juaj është anuluar për shkak, për shembull, të qarkullimit me të ultë se 200,000DM në vit, ju mund të mbeteni në biznes por nuk mund të aplikoni TVSH-në në konsumatorët tuaj e as të leshoni fatura tatimore. Eshtë e rëndësishme të mbahet në mend se regjistrimi i TVSH-së nuk mund të anulohet më herët se 12 muaj nga data kur regjistrimi ka hyrë në fuqi.

9) Kontrollët e TVSH-së

Rregullorja e tatimit mbi vlerën e shtuar ngarkon Administratën Tatimore të zhvillojë kontrollët në dokumentet dhe deklaratat. Administrata Tatimore ka një numër të mjaftueshëm të inspektorëve tatimorë, detyrë e të cilëve është të sigurojnë se personat e tatueshëm veprojnë në përputhje me dispozitat e rregullorës. Gjatë vizitë së inspektorëve tatimorë të gjitha tatimet e tjera që janë subjekt i biznesit tuaj poashtu do të kontrollohen.

Kontrollët mund të zgjidhen si zakonisht apo për arsye të veçanta, por nuk do të zgjidhen asnjëherë për shkaqe politike. Mund të ketë njoftim paraprak për vizitën, por vizita poashtu mund të përcillet edhe pa paralajmërim paraprak.

Nga ju do të kërkohet të bëhen të gjitha regjistrimet e kontabilitetit dhe dokumentacionit ndihmës në dispozicion sikurse edhe të gjithë dokumentacionet përkatëse që mund të përfshijë kontaktat, procesverbalet e takimeve, korrespondencat dhe preferencat që inspektori tatimor gjykon të jenë të nevojshme për të kompletuar kontrollin.

10) Deklarata e TVSH-së

Nëse jeni i regjistruar për TVSH dhe qarkullimi i biznesit tuaj është më i lartë se 200,000 DM në vit apo jeni eksportues, nga ju kërkohet të përgatisni deklaratën mujore të TVSH-së. Ju duhet të dorëzoni deklaratën në BPK apo MEB bashkë me pagesën e TVSH-së nëse keni, me apo përpara ditës së fundit punuese të muajit vijues të periudhës tatimore. Nga ju kërkohet të deklaroni çdo muaj. Çdo periudhë tatimore fillon me ditën 1 të muajit dhe përfundon në ditën e fundit të muajit. Nëse vonoheni në deklarimin apo pagesën e tatimit, do të zbatohen gjobat dhe kamata e duhur.

11) Rimbursimi i TVSH-së

Në muaj të caktuar biznesi juaj do të ketë shpenzime të cilat tejkalojnë të ardhurat të gjeneruara gjatë këtyre muajve dhe si rezultat tatimi i llogaritur do të jetë më i ulët se tatimi i zbritshëm. Për shembull, ju mund të dëshironi të merrni avantazh të uljës së çmimit në muajt e caktuar dhe të importoni sasi të mëdha të aparatave televizive që do t'i mbani në inventar. Shpenzimet tuaja për këtë muaj mund të tejkalojnë të ardhurat tuaja. Apo, nëse para se gjithash jeni eksportues, tatimi i zbritshëm i paguar në shpenzimet tuaja të prodhimit do të jetë i zbritshëm nga tatimi i llogaritur i cili në të vërtetë është 0, pra ju përsëri do të rezultoni në një situatë të tatimit të paguar tepër.

Nëse jeni person i tatueshëm me një qarkullim vjetor me më tepër se 200,000 DM, keni mbartur një tatim të paguar tepër për së paku gjashtë muaj të njëpasnjëshem dhe shuma e tij është më e lartë se 10,000 DM, ju lejoheni të kërkonte rimbursim të TVSH-së. Nëse jeni eksportues dhe keni mbartur një tatim të paguar tepër për më tepër se gjashtë muaj gjatë periudhës prej dymbëdhjet muajve, ju lejoheni të kërkonte rimbursim të TVSH-së një herë për çdo tremujor nëse teprica e tatimit të paguar tepër të cilin e mbartni është me e ulët se 10,000 DM. Nëse teprica e tatimit të paguar tepër është më e lartë se 10,000 DM, ju mund të kërkonte rimbursim një herë në muaj.

Të gjitha kërkesat për rimbursim do të kontrollohen për nga validiteti dhe saktësia përpara pagesës. Kjo mund të kërkojë një kontroll. Nëse një kontroll ekzekutohet, kërkesat do të jenë të njëjta sikurse janë sqaruar më sipër në pikën 9.

12) Bazat e kontabilitetit

TVSH-ja llogaritet në baza akruale. Kjo nënkupton se obligimi për TVSH lind kur njëra nga ngjarjet e mëposhtme ndodh e para:

- Kur lëshohet fatura;
- Kur mallrat dhe shërbimet janë të gatshme për blerësin;
- Kur pranohet pagesa.

Kjo është e rëndësishme të theksohet se ju do të jeni obligues për TVSH në shitje të mallrave dhe shërbimeve gjatë çdo periudhe tatimore madje edhe nëse ju nuk keni arketuar teresisht apo pjesërisht pagesën për një a disa furnizime tuajat.

TVSH-ja në lidhje me shpenzimet (TVSH e zbritshme) mund të zbritet nëse keni marrë një faturë tatimore e cila në rastin e importeve është deklaruar e unifikuar doganore.

13) Fatura Tatimore

Faturat Tatimore mund të lëshohen vetëm nga personat e tatueshëm të cilët janë të regjistruar dhe nga të cilët kërkohej të deklarohen. Lëshuarja e faturave tatimore nga personat të cilët nuk i plotësojnë këto kërkesa është kundërvajtje serioze dhe mund të merret veprim ligjor kundër kundërvajtësve të tillë. Përveç nëse janë subjekt i gjobes, këta persona do të kërkohej të paguajnë TVSH-në e aplikuar pa përfitim nga krediti i tatimit të zbritshëm.

Fatura tatimore duhet të lëshohet çdo herë kur personi i tatueshëm e i regjistruar kryen një furnizim të tatueshëm për bizneset e tjera. Kjo faturë duhet të lëshohet nëse paku dy kopje autentike, një për shitësin dhe një për blerësin. Shitësit me pakicë poashtu mund të lëshojnë fatura tatimore por gjithashtu në vend të tyre mund të lëshojnë edhe kuponat të kases regjistruese elektronike që duhet të përmbajjnë minimalisht të dhënat vijuese:

- Numrin Identifikues të TVSH-së dhe emrin e shitësit
- Datën dhe Numrin Serik
- Çmimin pa TVSH
- TVSH-në
- Çmimin Total të paguar nga blerësi

Në fund të ditës duhet të përgatitet një faturë përmbledhëse që liston vlerën totale (të përgjithshme) të të gjithë kuponave elektronike të lëshuar gjatë ditës.. Të dhënat e faturës tatimore përmbledhëse të tillë duhet të regjistrohen në Librin e Shitjeve në mënyrë të njëjtë sikurse të gjitha faturat e tjera tatimore. Kuponat elektronik nuk do të njihet si dokument zyrtar për kreditim të tatimit të zbritshëm.

Një format i Faturës Tatimore është treguar më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i mallit apo shërbimit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSh	Vlera pa TVSh	TVSh	Vlera totale përfshirë TVSh
1	2	3	4	5	6=4x5	7=6x15%	8=6+7
GJITHSEJT							
Furnizimet e tatueshme							
Furnizimet e përjashtuara							
Furnizimet me përqindje zero							
Emri dhe nënshkrimi i blerësit (_____)				Emri, nënshkrimi dhe vula e shitësit (_____)			

Fatura Tatimore

Numri serik

Data/Muaji/Viti
____/____/____

Emri i Shitësit	<input style="width: 80%;" type="text"/>
Numri ID i TVSh së shitësit	<input style="width: 80%;" type="text"/>
Adresa e shitësit	<input style="width: 80%;" type="text"/>
Numri i tel.	<input style="width: 80%;" type="text"/>
Emri i blerësit	<input style="width: 80%;" type="text"/>
Numri ID i TVSh së Blerësit(nëse ka)	<input style="width: 80%;" type="text"/>
Adresa e blerësit	<input style="width: 80%;" type="text"/>
Numri i tel.	<input style="width: 80%;" type="text"/>

14) Nota e kreditit

Shitesi lëshon Notë Krediti kur çmimi i furnizimit është zvogëluar pasi të jetë lëshuar Fatura Tatimore. Për shembull, kjo mund të shfaqet kur cmimi I mallrave është zvogëluar për shkak të defektit të gjetur apo kur një ulje e cmimit është dhënë.

Ekziston ndryshim i vogël në mes të Notës së Kreditit sipas sistemit të TVSH-së dhe notave kreditore të lëshuar gjatë kursit të rregullt të biznesit. Sikurse Fatura Tatimore, Nota e Kreditit duhet të përmbajë emrin tregtar të biznesit, numrin e regjistrimit të biznesit që lëshon notën kreditore, numrin serik të faturës tatimore origjinale lidhur me të, shumën e zvogëlimit dhe TVSH-në që aplikohet në zvogëlim.

15) Nota e debitit

Furnizuesi lëshon Nota Debiti kur çmimi është rritur pasi të jetë lëshuar Fatura Tatimore. Fjalet Note Debiti duhet të shkruhen në vend të dalluar të fatures tatimore. Sikur për notën kreditore, Nota e Debitit duhet të përfshijë emrin tregtar të biznesit, numrin e regjistrimit të biznesit që lëshon notën debitore, numrin serik të fatures tatimore origjinale lidhur me të, shumën e rritjes dhe TVSH-ne që aplikohet në rritje.

16) Agjentët

Ndonjëherë një agjent blen apo shet mallra dhe shërbime për dikë tjetër (Kryesori). Kryesori ende është blerës apo shitës dhe jo agjenti.

Nese kryesori dhe agjenti janë të regjistruar, agjenti mund të leshojë fature tatimore në emër të kryesorit. Fatura Tatimore ka nevojë të lëshohet vetëm në emër të kryesorit dhe nuk ka nevojë që agjenti të përfshijë emrin e tij në faturë. Kryesori nuk mund të leshojë fature tatimore për furnizimin e njejtë. Megjithatë vetëm kryesori mund të kërkojë tatimin e zbritshëm për blerjet apo të aplikojë TVSH-ne për shitjet dhe të deklarojë tatimin e llogaritur.

Nëse agjenti blen mallra për kryesorin furnizimi gjykohej të jetë kryer për kryesorin dhe jo për agjentin. Megjithatë, agjenti mund të kërkojë nga furnizuesi Faturën Tatimore duke treguar se furnizimi është kryer për kryesorin.

Në të kundërtën, vetëm kryesori mund të përfshijë tatimin e zbritshëm apo tatimin e llogaritur në deklaratën mujore për shitjet apo blerjet të kryera për të nga agjenti i tij.

Agjenti duhet të mbajë shënime lidhur me emrin, adresën dhe numrin e regjistrimit të kryesorit për secilin transaksion. Nese agjenti është person i regjistruar, ai/ajo do të aplikojë TVSH-ne në kryesorin por vetëm në shumën e komisionit.

17) Veprimtaria ekonomike

Veprimtaria ekonomike është kryerja e veprimtarisë së biznesit për qëllime fitimi pa marrë parasysh a rezulton me fitim ajo veprimtaria apo jo. Ajo përfshin furnizimin e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve për konsideratë ose blerjen apo shitjen e mallrave a shërbimeve për para, apo ndryshe, tregtimi i një malli për një tjetër, prodhimi, transporti bujqësia, minierat, peshkimi, shërbimet e telekomunikacionit etj.

18) Furnizimet e tatueshme me zero përqind

Furnizimet e tatueshme me zero % janë furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të tatuara me zero përqind. Furnizimet me zero përqind momentalisht janë të kufizuara vetëm për eksportet, Daljet drejt RFJ-se dhe transportimi ndërkombëtar i mallrave dhe udhëtareve.

Personat e regjistruar të cilët kryejnë furnizime të tatueshme me zero duhet të regjistrohen dhe duhet të deklarojnë por nuk do të ketë tatim të llogaritur në këto

furnizime pasi që keto janë të tatueshme me zero përqind. Sidoqoftë këta persona të tatueshëm do të deklarojnë tatimin e zbritshëm në importet e tyre, Hyrjet nga RFJ dhe blerjet e tatueshme në Kosovë. Furnizimet e pastra të furnizimeve me norme 0 do të jenë gjithmone në pozite kreditore dhe do të lejohen të kërkojnë rimbursim sikurse është sqaruar më lart në paragrafin 11.

19) Shitja e veprimtarisë ekonomike

Shitja e një veprimtarie ekonomike apo pjesë të saj nga personi I tatueshëm nuk është furnizim i tatueshëm me kusht që personi I cili e blen veprimtarinë ekonomike është një person I regjistruar gjatë kohës së transakcionit ose bëhet një person I regjistruar brenda 30 ditëve pas transakcionit. Përndryshe, shitja e veprimtarisë ekonomike është furnizim i tatueshëm.

20) Misionet e Ndërlidhjes, perfaqësuesit diplomatike, UNMIK-u, KFOR-i, Banka Botërore, Organizatat Ndërkombëtare Nderqeveritare

Importet, Hyrjet nga RFJ dhe blerjet në Kosovë të kryera nga Misionet e Ndërlidhjes (Koordinimit), Kombet e Bashkuara apo organet e tij duke përfshirë UNMIK-un, KFOR-i, Banka Botërore, Agjensitë e KB dhe Organizatat Ndërkombëtare Nderqeveritare janë të lira nga TVSH-ja . Kjo do të thotë se ato nuk duhet të paguajnë tatimin mbi vlerën e shtuar në importe, Hyrje nga RFJ dhe blerjet e tatueshme në Kosovë.

Importet, Hyrjet nga RFJ dhe blerjet e tatueshme në Kosovë të kryera nga qeveritë, agjensitë qeveritare, organizatat qeveritare apo nderqeveritare, janë poashtu të përjashtuara me kusht që janë për krahas të programeve dhe projekteve humanitare dhe rindertuese në Kosovë.

21) Individët

Individë të ndryshëm importojnë apo kryejnë Hyrje nga RFJ të mallrave në Kosovë sikurse janë automjetet, mobiljet apo aparatet televizive për përdorim personal. Nëse vlera e mallrave të tilla është më e lartë se limiti i lirës për gjesende personale të paraqitur në Legjislacionin Doganor, këta individë do të paguajnë tatimin mbi vlerën e shtuar në kufi apo Linjen Administrative Kufitare në vlerën e tatueshme në tejkalimin e limitit të lirim. Këta individë nuk kërkohet të regjistrohen.

22) Importet dhe Hyrjet nga RFJ

Importet dhe Hyrjet nga RFJ i nënshtrohen tatimit mbi vlerën e shtuar në normë prej 15% në vlerën e tatueshme të atyre mallrave. Tatimi mbledhet (arkëtohet) si pjesë e procedurës normale doganore në pikën e hyrjes të Kosovës. Dokumenti i unifikuar doganor konsiderohet si faturë tatimore. Keto dokumente duhet të mbahen nga personat e tatueshëm nëse dëshirojnë të zbrisin tatimin e zbritshëm nga tatimi I llogaritur në deklaratën e tyre të TVSH-se.

23) Furnizimet e përjashtuara

Furnizimet e përjashtuara janë furnizimet e mallrave dhe shërbimeve ne te cilat furnizuesi nuk mund te mbledhe tatimin mbi vleren e shtuar. Ato jane:

- Furnizimi i barerave, shërbimeve mjekesore dhe pajisjeve mjekesore
- furnizimi I shërbimeve financiare;
- furnizimi i shërbimeve të edukimit publik
- transferimi i pronësise se tokes dhe shtëpive te banimit si edhe qeraja e shtëpive te banimit,
- furnizimet e importuesve vegjël (me qarkullim vjetor më pak se 200,000 DEM);
- Furnizimi me leje dhe licenca për pagesë nga autoritetet komunale apo publike;
- Gjobat apo ndëshkimet të lëshuara nga autoritetet e UNMIK-ut.

Furnizuesi i furnizimeve te perjashtuara nuk eshte I lejuar per kreditim te tatimit te zbritshem.

24) Furnizimet e perziera

Në qëftë se biznesi i kryen të dyja si furnizimet e përjashtuara ashtu edhe ato të tatueshme, nje perlllogaritje e tatimit te zbritshem duhet te behet bazuar ne pjesen proporcionale te furnizimeve te tatueshme dhe furnizimeve te perjashtuara.

Sikurse u permend ne piken 23, furnizuesi I furnizimeve te perjashtuara nuk eshte I lejuar per kreditim te tatimit te zbritshem. Si pasoje, pjesa e TVSH-se se zbritshme qe i perket furnizimeve te perjashtuara duhet te pakesohet nga TVSH e zbritshme.

Koeficienti i duhet te llogaritet si vijon:

$$\text{Koeficienti i Kreditimit Tatimor} = \frac{\text{Furnizimet e tatueshme}}{\text{Furnizimet e tatueshme} + \text{Furnizimet e përjashtuara}}$$

Shuma totale e tatimit te zbritshem pastaj shumezohet me koeficientin. Prodhimi eshte shuma e tatimit te zbritshem te lejueshem qe mund te zbritet nga tatimi I llogaritur per periudhen tatimore.

25) Sigurimet

Ofrimi apo transferi I pronësise I nje kontrate te sigurimit jetesor apo risigurimi eshte sherbim financiar dhe si I tille eshte furnizim I perjashtuar. Kjo nenkupton se kompanite e sigurimit te cilat leshojne polisa te tilla te sigurimit nuk mund te mbledhin tatimin ne vleren e shtuar dhe nuk lejohen te kreditojne tatimin e zbritshem.

Te gjitha llojet e tjera te sigurimit te pronësise konsiderohen si furnizime te tatueshme dhe kompanite e sigurimit duhet te mbledhin tatimin mbi vleren e shtuar ne keto polisa te sigurimit dhe lejohen te kreditojne tatimin e zbritshem.

Të gjitha polisat e sigurimit ndryshe nga sigurimi jetësor dhe risigurimi i nënshtrohen TVSH-së. Kjo zbatohet si në polisat private ashtu edhe të biznesit. Bizneset e sigurimit te

regjistruara ne TVSH mund të kërkojnë kreditim tatimi për TVSH-në e paguar gjate kryerjes se aktivitetit te tyre.

26) Ndertimi

Ndertimi konsiderohet si furnizim I tatueshem I sherbimit per te cilin duhet aplikuar tatimi mbi vleren e shtuar. "Situacioni e Perparimit te Puneve" konsiderohet si fature tatimore per kompanite e ndertimit.

27) Mbajtja e regjistrimeve

Çdo person i tatueshëm duhet të mbajë Librin e Shitjes ku të gjitha shitjet duhet te regjistrohen dhe Libri I Blerjes ku duhet te regjistrohen te gjitha blerjet.

Forma e Librit të shitjes është si vijon:

Fatura				Shitjet Totale (Baza e tatueshme per Tat. E Paragjyk)	Shitjet e Përfshijtura	Shitjet e Tatueshme		
Data	Numri	Blerësi	NIT i blerësit (nëse ka)			Eksportet, Daljet dhe furnizimet me 0%	Vlera e tatueshme me 15%	TVSh
A	B	C	D	e=f+g+h	f	G	H	i
Gjithsej								
Numri i kutisë në Deklaratën Tatimore					9	10	11	12

Forma e Librit të Blerjeve është si vijon:

Fatura				Blerje me TVSH Te pazbritshme dhe pa TVSH	Blerjet që i nënshtrohen TVSh-së			
Data	Numri	Emri i Shitësit	NIT i shitësit		Inmportet		Blerjet Vendore	
					Vlera e tatueshme	TVSh	Vlera e tatueshme	TVSh
a	b	C	d	e	f	g	H	I
Gjithsej								
Numri i kutisë në Deklaratën tatimore				Kutija 13	Kutija 14	Kutija 15	Kutija 16	Kutija 17

28) Deklarimi

Te gjithë personat e tatueshem me qarkullim vjetor bruto me te larte se 200,000DM dhe te gjithë eksportuesit duhet te paraqesin deklaraten mujore. Formulari perfshin tri kopje. Kur te dorezoni deklaraten tatimore ne sportelet e BPK-se apo MEB-it, sportelisti duhet plotesoje pjesen e BPK/MEB-it, te neshkruajne dhe te vene daten dhe t'u japin juve kopjen e trete.

Forma e deklarates se TVSH-se eshte si vijon:



Central Fiscal Authority



FORMULAR I DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TVSH

[1] Periudha tatimore Numri serik [3] Numri i provizor i regjistrimit të biznesit [4] Numri I perkohshem tatimor [5] Emri i biznesit [6] Adresa e biznesit Telefoni [7] Emri i pronarit Telefoni

[8] Vendosi 'X' këtu nëse nuk ka ndodhur asnjë transaksion gjatë periudhës tatimore per te cilen po deklaroni. Vetëm nënshkruani dhe dorëzoni deklaratën në bankën e autorizuar..

TVSh e llogaritur për muajin

Vlera e tatueshme

TVSh e llogaritur

[9] Shitjet e përjashtuara [10] Eksportet, Daljet drejt RFJ-se dhe furnizime me 0% [11] Shitjet e tatueshme në Përqindje normale 15%

TVSh e zbritshme për muajin

Vlera e tatueshme

TVSh e zbritshme

[13] Blerjet pa TVSH dhe me TVSH jo te zbritshme [14] Importet dhe Hyrjet nga RFJ [16] Blerjet e tatueshme vendore në Përqindje normale 15%

Rregullimet

[18] Krediti nga TVSh i bartur nga muaji i kaluar [19] Kërkesa për rimbursim nga tatimi i paguar tepër [20] Balansa kreditore nga muaji i kaluar [18]-[19] [21] Balansa kreditore e përgjithshme për muajin [21]=[15]+[17]+[20] [22] Balansa kreditore e mbetur [21]-[12] nëse [21]>[12]

(dërgoje në kutinë [18] të deklaratës së muajit të ardhshëm)

[23] TVSh që duhet paguar [12]-[21] nëse [12]>[21] [24] Ndëshkimet për deklarim dhe pagesë të vonuar [25] Obligimi i përgjithshëm që duhet paguar [23]+[24]

Deklaroj se informatat e përfshira janë të sakta.

Emri dhe nënshkrimi

dd/mm/vv

Pjesa e pagesës së BPK/MEB

Informatat bankare të pagesës		Nr.	DEM	Vlera
Numri i llogarisë	XXXXXXXXX			
Mbajtësi i llogarisë/Buxheti i Konsoliduar i Kosovës	Dega/Referenca e transferit		1000	
	Data/Nënshkrimi/Vula		500	
Valuta	Shuma		200	
Ref. e klientit.	Data e vlerës		100	
Teksti			50	
			20	
			10	
			5	

Ministria e Ekonomisë dhe Financave
Administrata Tatimore

29) Si të plotësohet deklarata juaj e TVSH-së?

Ky është një udhëzues i shkurtër se si të plotësohet deklarata mujore e TVSH-së. Megjithatë deklarata duket shumë më e komplikuar se sa në të vërtetë është, të gjitha udhëzimet që nevojiten për të plotësuar deklaratën do të jenë në anën tjetër të formularit të deklaratës.

Ju lutemi të analizoni shembullin e deklaratës së TVSH-së. Nuk do të keni ndonjë vështirësi në plotësimin e deklaratës por po që se vjen rasti, sikurse u tha më lart, keni në detaje 'Udhëzimi për plotësimin e deklaratës' në anën tjetër të deklaratës.

Ja përmbledhja e udhëzimit se si të përgatitet deklarata e TVSH-së. Deklarata e TVSH-së ka tri pjesë kryesore:

Pjesa e Parë

Kutia[1]- Plotësoni periudhën tatimore, si shembull Korrik 2001-05-01

Kutia[3]- Vendoseni Numrin e Provizor të Regjistrimit të Biznesit

Kutia[4]- Nëse e keni një, vendoseni Numrin e Përkohshëm Tatimor

Kutia[5]- Plotësoni emrin e biznesit

Kutia[6]- Jepni Adresën e Biznesit tuaj

Kutia[7]- Jepni emrin e pronarit/menagjerit

Kutia[8]- Nëse nuk ka transakcione gjatë tërë muajit, vendosni 'X' dhe nënshkruani dhe dorëzoni deklaratën në sportelet e bankës.

Pjesa e Dytë

Kutia[9]- Mbushni furnizimet tuaja të përjashtuara. Merrni atë nga shtylla 'f' të Librit të Shitjes

Kutia[10]- Mbushni furnizimet me përqindje 0, eksportet dhe Daljet nëpërmjet RFJ-së. Merrni atë nga shtylla 'g' e Librit të Shitjes

Kutia[11]- Mbushni Vlerën e tatueshme të furnizimeve me përqindjen normale 15%. Merrni atë nga shtylla 'h' e Librit të Shitjes

Kutia[12]- Mbushni TVSH-në e aplikuar gjatë muajit. Merrni atë nga shtylla 'i' e Librit të Shitjes

Kutia[13]- Mbushni blerjet e liruar nga tatimi dhe ato pa TVSH. Merrni atë nga shtylla 'e' e Librit të Blerjes

Kutia[14]- Mbushni Vlerën e Tatueshme të Importeve dhe Hyrjeve nga RFJ. Merrni atë nga shtylla 'f' e Librit të Blerjes

Kutia[15]- Mbushni TVSH-në e paguar në importet dhe Hyrjet nga RFJ. Shfrytëzoni shtyllën 'g' të Librit të Blerjes

Kutia[16]- Mbushni vlerën e tatueshme të blerjeve brenda vendit. Merrni atë nga shtylla 'h' e Librit të Blerjes

Kutia[17]- Tregoni TVSH-në e paguar në blerjet e tatueshme brenda vendit. Merrni atë nga shtylla 'i' e Librit të Blerjes

Kutia[18]- Mbushni TVSH-në e paguar tepër të bartur nga muaji i kaluar. Merrni atë nga kutia [22] e deklaratës tatimore të muajit të kaluar

Kutia[19]-Nëse balanca e treguar në kutinë[18] është bartur për gjashtë muaj të njëpasnjëshëm dhe vlera është më e lartë se 10,00 DEM ju lejohet për rimbursim
Kutia[20]-Nëse [18]>[19] bëni zbritjen [18]-[19] dhe vendosni rezultatin në kutinë [20]
Kutia[21]-Mblidhni Totalin e Kreditit Tatimor[21] = [15]+[17] +[20]
Kutia[22]-Llogaritni Balancën Kreditore të mbetur [22]=[21]-[12] nëse[21]>[12]
Kutia[23]-Llogaritni TVSH-në e pagueshme [23]=[12]-[20] nëse[12]>[12]
Kutia[24]-Vendosni çdo gjobë dhe kamatë për deklarim dhe pagesë të vonuar
Kutia[25]-Obligimi i përgjithshëm (total) =[23]+[24]

Pjesa e Tretë

Nënshkruani dhe vëni datën Deklaratës Tatimore dhe lëreni pjesën e tretë zbrazur që mbushet nga arkëtari (sportelisti) i bankës. Pasi të jeni nënshkruar dhe vulosur të tri kopjet sportelisti do t'ju mbaje dy kopjet e para dhe t'ju japë kopjen e tretë juve. T'ju perkujtojmë se data e dorëzimit në banke do të skanohet automatikisht nga kompjuteret tane për të aplikuar apo jo gjobat dhe kamaten për deklarim dhe pagesë të vonuar.

30) Borxhi i Keq

Një borxh konsiderohet Borxh i Keq kur të jenë permbushur kushtet vijuese:

- 1.Tërësisht ose pjesërisht pagesa për furnizimin e tatueshëm nuk është marrë nga furnizuesi,
- 2.Kanë kaluar së paku gjashtë muaj pas periudhës tatimore për të cilën është ngarkuar TVSH-ja në lidhje me atë furnizim,
- 3.Shitësi duhet të vërtetojë se ai ka ndërmarrë të gjithë hapat ligjore për të mbledhur atë borxh përpara se ai/ajo të lëshojë Faturën për Borxh të Keq. Kuptimi i 'të gjithë hapave ligjor' është se evidenca duhet të ekzistojë që tërë përpjekjet për të mbuluar atë janë ndërmarrë. Evidenca e tillë do të përfshijë çdo vendim të dhënë nga Gjyqji në Kosovë në lidhje me borxhin në mënyrë që të vërtetojë se ai është pamundur të arketohet.

Në qoftë se të tri kushtet plotësohen, shitësi duhet të lëshojë një Faturë për Borxh të Keq e cili është e përgatitur në format të njëjtë si një faturë normale. Fatura e tillë duhet të përmbajë fjalët "Fatura e Borxhit të Keq" dhe duhet t'ju referohet numrit serik të faturës origjinale për të cilën pagesa apo pjesë e pagesës nuk është marrë. Kjo faturë pastaj shfrytëzohet nga shitësi për të zvogëluar obligimin tatimor dhe blerësit t'ju zvogëlohet zvogëlimi i tatimit të zbritshëm duke u regjistruar me (-) në librin e shitjes së shitesit dhe po me (-) në librin e blerjes së blerësit.

31) Mjetet Kryesore

Per disa mjete kryesore (makineri e pajisje) që shërbejnë për prodhimin e mallrave e shërbimeve dhe për biznese të themeluara rishtaz, mund të jepet një shtyrje deri në 6 muaj e pagesës së TVSH në momentin e importimit a të Hyrjes nga RFJ kundrejt një garancie bankare.

Personi i tatueshëm ka 6 muaj t'ju ripaguajë borxhin Administratës Tatimore. Nëse brenda periudhës 6-mujore personi i tatueshëm fillon prodhimin e mallrave e shërbimeve ai duhet të lëshojë një faturë tatimore me vleften e mjetit kryesor dhe me TVSH perkatëse. Ai duhet ta regjistrojë atë si në librin e shitjes ashtu edhe në atë të blerjes. Në

kete menyre TVSH per mjetin kryesor zerohet dhe personi i tatueshem duhet te paguaje tere TVSH e llogaritur per ate muaj (kuptohet minus ndonje TVSH tjetër te zbritshme per ate muaj). Nëse në fund të periudhës 6 mujore borxhi nuk është ripaguar tërësisht, Administrata Tatimore mund të urdhërojë bankën të mbulojë diferencën nga garancioni.

32) Rikthimi

Kontraktuesit e UNMIK-ut, agjensioneve të specializuara të KB-së, KFOR-it, Bankes Botërore, Agjensioneve Ndërqeveritare kanë të drejtë të kërkojnë një rikthim të TVSH se paguar në importe të Hyrje nga RFJ nëse paraqesin pranë Administratës Tatimore kopjet autentike të Deklaratave Doganore duke vërtetuar se TVSH-ja është paguar në importet apo Hyrjet nëpërmjet RFJ-së si dhe kopje të kontratave me trupat e përmendur më lart. Po kështu këto lehtësi mund ta përfitojnë edhe ato Organizata Joqeveritare që gëzojnë statusin e përfitimit publik me kusht që të paraqesin dokumenta që vërtetojnë se mallrat e sjellura në Kosovë janë shfrytëzuar ekskluzivisht për qëllime bamirëse apo për përfitim publik, sikurse janë listat e përfituesve, deklaratat nga komunat apo trupat e tjerë përfitues të ndihmes, deklaratat nga përfituesit individuale etj., si edhe kopjet autentike të Deklaratave Doganore që vërtetojnë se TVSH-ja është paguar në importet apo Hyrjet nëpërmjet RFJ-së.

33) Tatimet e tjera

Tatimi në Shitje që aktualisht aplikohet në kufinj dhe Linjat Administrative Kufitare do të anulohet më 1 Korrik 2001 me paraqitjen e TVSH-së. Nuk do të lejohet kurrëfarë tatimi i zbritur apo kreditim pas 1 Korrikut 2001 për Tatimin në Shitje të paguar në Doganë përpara asaj date. Nëse tatimpaguesi ka një borxh të pashlyer të tatimit në shitje, do të mbetet i mbledhshëm (arketueshem) nga Autoritetet Tatimore pas 1 Korrikut 2001.

Tatimi në Shërbime në Hotel, Ushqim dhe Pije do të anulohet më 1 Korrik 2001 me paraqitjen e TVSH-së. Tatimpaguesit e këtij tatimi ende do të jenë subjekt i kontrollit për periudhë prej tre vjet dhe si rezultat kërkohet të mbajnë librat dhe regjistrimet të gatshme për kontroll. Çdo borxh i pashlyer do të mbetet i mbledhshëm (arketueshem) pas asaj date nga Autoritetet Tatimore.

Tatimi i Paragjykuar do të vazhdojë të zbatohet. Personat e tatueshëm mund të pushojnë t'i mbajnë Librat e Tatimit të Paragjykuar dhe në vend të tyre të përdorin Librat e TVSH-së. Shuma e treguar në shtyllën "e" në Librin e Shitjes të TVSH-se për secilin prej tre muajve duke përfshirë në tremujorin për tatimin e paragjykuar do të mblidhet dhe do të shërbejë si bazë për llogaritjen e Tatimit të Paragjykuar për periudhën tatimore. TVSH nuk do të ketë ndikim në Tatimin e Paragjykuar të tatimpaguesve të tjerë.

34) Shembull

Më poshtë po u japim një shembull shumë të thjeshtë se si punon TVSH-ja:

'ALBKOS' është një kompani për prodhimin e mobiljeve. Gjatë muajit Korrik 2001 kompania ka kryer transaksionet vijuese:

Nr	Transakcioni	Vlera e blerjes	TVSH në blerjet	Vlera e shitjes	TVSH në shitje	TVSH e pagueshme
1.	Blerja e drurit	100,000	15,000			
2.	Blerja e ngjitësit	30,000	4,500			
3.	Importimi i lën.së p	10,000	1,500			
4.	Blerja e energjisë	10,000	1,500			
5.	Eksportimi i mobilj			100,000	0	
6.	Shitja e mobiljeve			200,000	30,000	
7.	Shitja e mobiljeve			100,000	15,000	
8.	Blerja e makinerisë	100,000	15,000			
	TOTALI	250,000	37,500	400,000	45,000	7,500

Gjatë muajit Korrik kompania regjistron në baza ditore të gjitha transakcionet në librat përkatës. Të shohim si duken:

Libri i Shitjes

Fatura				Shitjet Totale (Baza e tatueshme për T. e P).	Shitjet e Përfunduar	Shitjet e Tatueshme		
Data	Numri	Blerësi	NIT i blerësit (nëse ka)			Eksportet, Daljet dhe furnizime me 0%	Vlera e tatueshme me 15%	TVSh
A	B	C	d	e=f+g+h	f	g	H	i
11.07.01	XXX	YYY	ZZZ	100,000		100,000		0
12.07.01	AAA	BBB	CCC	200,000			200,000	30,000
20.07.01	DDD	VVV	NNN	100,000			100,000	15,000
Totali				400,000		100,000	300,000	45,000
Numri i kutisë në Deklaratën Tatimore					9	10	11	12

Libri i Blerjes

Fatura				Blerje me TVSH të pazbritshme e pa TVSH	Blerje me TVSH të zbritshme			
Data	Numri	Emri i shitesit	NIT i Shitesit		Importe		Blerje në vend	
					Vlera e tatueshme	TVSH	Vlera e tatueshme	TVSH
A	b	C	D	e	f	g	H	I
02.07.01	Hhh	Uuu	Jjj				100,000	15,000
05.07.01	Lll	Kkk	Sss				30,000	4,500
07.07.01	Mmm	Nnn	-		10,000	1,500		
23.07.01	Ccc	Ggg	fff				10,000	1,500
24.07.01	Jnh	Wsd	hgt				100,000	15,000
Totali					10,000	1,500	240,000	36,000
Numri i kutisë në deklaratën tatimore				Kutia 13	Kutia 14	Kutia 15	Kutia 16	Kutia 17

Në fund të muajit që vjen deklarata tatimore duhet dorëzuar. Të shohim si duket ajo:



Central Fiscal Authority



FORMULARI I DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TVSH

[1] Periudha tatimore Numri serik

[3] Numri i provizional i regjistrimit të biznesit [4] Numri I perkohshem tatimor

[5] Emri i biznesit

[6] Adresa e biznesit Telefoni

[7] Emri i pronarit Telefoni

[8] Vendosni plus këtu nëse nuk ka ndodhur asnjë transaksion gjatë periudhës së kaluar tatimore. Vetëm nënshkruani dhe dorëzoni deklaratën në bankën e autorizuar..

TVSh e llogaritur për muajin	Vlera e tatueshme	TVSh e llogaritur
[9] Shitjet e përjashtuara	[9] -	
[10] Eksportet, Daljet nëpërmjet RFJ-së dhe furnizi. me 0%	[10] 100,000	
[11] Shitjet e tatueshme në Përqindje normale 15%	[11] 300,000	[12] 45,000
TVSh e zbritshme për muajin	Vlera e tatueshme	TVSh e zbritshme
[13] Blerjet pa TVSH e me TVSH jo te zbritshme	[13] -	
[14] Importet dhe Hyrjet nëpërmjet RFJ-së	[14] 10,000	[15] 1,500
[16] Blerjet e tatueshme vendore në Përqindje normale 15%	[16] 240,000	[17] 36,000
Rregullimet		Balansi kreditor i TVSh
[18] Krediti nga TVSh i bartur përpara nga muaji i kaluar	[18]	[20]
[19] Kërkesa për rimbursim nga tatimi i paguar tepër	[19]	[21] 37,500
[20] Balansi kreditor nga muaji i kaluar [18]-[19]		[22]
[21] Balansa kreditore e përgjithshme për muajin [21]=[15]+[17]+[20]		[23] 7,500
[22] Balansa kreditore e mbetur [21]-[12] nëse [21]>[12] (dërgoje në kutinë [18] të deklaratës së muajit të ardhshëm)	[22]	[24] -
[23] TVSh që duhet paguar [12]-[21] nëse [12]>[21]		[25] 7,500
[24] Ndëshkimet për deklarim dhe pagesë të vonuar		
[25] Obligimi i përgjithshëm që duhet paguar [23]+[24]		

Deklaroj se informatat e përfshira janë të sakta.

Emri dhe nënshkrimi

dd/mm/vv

(_____)

Pjesa e pagesës së BPK/MEB

Informatat bankare të pagesës				
Numri i llogarisë	Dega/Referenca e transferit	Nr.	DEM	Vlera
XXXXXXXXXX	Data/Nënshkrimi/Vula	7	1000	7,000
Mbajtësi i llogarisë/Buxheti i Konsoliduar i Kosovës		1	500	500
Valuta	Shuma		200	
Ref. e klientit.	Data e vlerës		100	
Teksti			50	
			20	
			10	
			5	

Ministria e Ekonomisë dhe Financave
Administrata Tatimore

35) Përfundimi

Ky doracak është dizajnuar si përmbledhje informative për TVSH.

Megjithatë, rekomandohet që si pjesë e praktikës normale të biznesit të kërkoni këshilla profesionale nëse nuk jeni i sigurtë për ndonjë procedure apo aspekt teknik të TVSH-së që ju mund të ndeshni në lidhje me biznesin tuaj.